

Përshëndetje,

Jam Eraldo Harlicaj, gazetar, ju shkruaj për t'u informuar mbi dy pyetje në lidhje me Aeroportin Ndërkombëtar të Kukësit.

Ju lutem, a mund të më informoni nëse vendosja e paneleve anash pistës së aeroportit është e lejuar, aq më tepër për një gjatësi 1-2 km?

E dyta, a ka një tjetërsim të aeroportit të Kukësit që ajo tokë të kthehet në një aktivitet tjetër biznesi? A ka një leje të posaçme nga ju që të kthehet në një stacion fotovoltaik?

E treta, a është bllokuar licenca e aeroportit të Kukësit, apo mbyllur totalisht?

Shpresoj në një përgjigje sa më të shpejtë. Bashkëngjitur gjeni mjetin tim të identifikimit si gazetar.

Faleminderit,
Eraldo Harlicaj.

Përshëndetje,

Në lidhje me kërkesën e z.Eraldo Harlicaj ju informojmë respektivisht për pyetjet si vijon:

1. A mund të më informoni nëse vendosja e paneleve anash pistës së aeroportit është e lejuar, aq më tepër për një gjatësi 1-2 km?

1. Panelet fotovoltaike janë një burim energjie që mund t'i japë pavarësi operatorëve të aerodromeve për plotësimin apo përmbushjen e nevojave të aeroporteve. Meqenëse e gjithë industria e aviacionit është angazhuar në uljen e impaktit të karbonit, panelet fotovoltaike janë një nga teknologjitë që mund të përdoren në këtë drejtim. Shpesh aeroportet kanë sipërfaqe të mëdha të pashfrytëzuara toke apo mbi objektet e terminaleve apo godinave ndihmëse, të cilat mund të shfrytëzohen për këtë teknologji. Nje shembull i implementimit te paneleve ne aeroporte eshte dhe instalimi i tyre pranë Aeroportit të Vjenës. Gjithashtu kjo edhe në referencë të Strategjisë së Europës për planin e tranzicionit nepermjet paketes Fit for 55, per mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e emetimeve. Objektivi i Aviacionit Civil në këtë drejtim është që nga 2030 të kemi reduktim te emetimeve te gazrave ne zero.

Përsa i përket vendosjes së paneleve përkrah pistës në gjatësi 1-2 km, sqarojmë se vendosja e paneleve foto-voltaike nuk është e lejuar në zonën e rripit të pistës, një zonë e përcaktuar kjo që përfshin gjithashtu pistën dhe që shërben për të siguruar mbrojtjen nga rreziku i dëmtimit të avionëve gjatë operimit të tyre në ulje, ngritje apo operimet në tokë. Përtej kësaj sipërfaqe mund të lejohet vendosja e objekteve, me lartësi të tillë që nuk çënojnë sipërfaqen e kufizuar të pengesave, e cila është një sipërfaqe që përcakton kufijtë e parashikuar, në të cilat objektet mund

të projektohen në hapësirën ajrore rreth aerodromit në mënyrë që operacionet e avionëve në aerodrom të kryhen në mënyrë të sigurtë, në përputhje me kërkesat e zbatueshme të Urdhrit të Ministrit Nr.130, datë 9.11.2012 “Për miratimin e rregullores për certifikimin dhe regjistrimin e aerodromeve civile në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorëve të aerodromeve.”

2. A ka një tjetërsim të aeroportit të Kukësit që ajo tokë të kthehet në një aktivitet tjetër biznesi? A ka një leje të posaçme nga ju që të kthehet në një stacion fotovoltaik?

Përsa i përket lejeve për vendosje të impianteve fotovoltaike, sqarojmë se kjo leje është kompetencë e strukturave përgjegjëse pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të shprehet mbi vlerësimin e impaktit që vendosja e paneleve mund të ketë në sigurinë në operim të avionëve, navigimin ajror si dhe sigurinë në aviacion.

3. A është bllokuar licenca e aeroportit të Kukësit, apo mbyllur totalisht?

Aeroporti i Kukësit është certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar dhe ka një certificate të vlefshme për të operuar, sipas kushteve të përcaktuara dhe publikuara në AIP Albania.